



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.18/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Faton Ademi kryesues, Rustem Thaqi dhe Adnan Konushevcu anëtarë, me pjesëmarrjen e Zyrtares së Lartë Ligjore Valbona Millaku Foniqi, duke vendosur përkitazi me apelin e subjektit politik Partia Liberale Egjiptiane (PLE) me seli në Pejë, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me nr. 218/2021 të datës 22.01.2021, për certifikimin e kandidatës për deputet Sabina Berisha, në listën e kandidatëve të subjektit politik Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës (IRDK) me seli në Pejë, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen 14.01.2021, në seancën e panelit të mbajtur, me datë 31.01.2021, mori këtë:

V E N D I M

Hudhet i pasafatshëm apeli i ushtruar nga subjekti politik Partia Liberale Egjiptiane (PLE) me seli në Pejë Anr.18/2021 i datës 28.01.2021, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me nr. 218/2021 të datës 22.01.2021, për certifikimin e kandidatës për deputete Sabina Berisha, në listën e kandidatëve të subjektit politik Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës (IRDK) me seli në Pejë.

A r s y e t i m

Me datë 28.01.2021, PZAP-i, ka pranuar një apel nga subjekti politik Partia Liberale Egjiptiane (PLE) me seli në Pejë, në të cilin pretendon se me datën 22.01.2021 subjekti politik Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës IRDK, është informuar nga KQZ-ja, se lista e kandidatëve është certifikuar duke u bazuar në vendimin 218-2021 përmes të cilit vendim miratohet rekomandimi i Zyrës për certifikimin e 38 kandidatëve të subjektit IRDK, ku ne mesin e tyre sipas listës se bashkangjitur te vendimit 218-2021 me numër rendor 9 është edhe kandidatja Sabina Berisha. Më tutje në apel parashtruesi thekson se me datën 20.01.2021 Sabina Berisha deklaroi në profilin e saj Facebook, se ka pranuar shume kritika dhe shqetësime për nominimin e saj që është e emëruar si nënkryetare e IRDK-së, për zgjedhjet e 14 Shkurtit 2021, dhe se e cila deklaroi publikisht se i takon komunitetit rom dhe se do të vazhdoje të i mbron të drejtat e komunitetit Rom pa tentuar të asimilohet në një komunitet tjetër. Po ashtu në apel theksohet se IRDK është parti e komunitetit Egjiptian e cila në secilën pale zgjedhje garon për vendet e garantuara për komunitetin Egjiptian, dhe se në rastin konkret shqetësimi jone ka të beje me dilema rreth kandidaturës së zonjës në fjale e cila deklaroi se i takon komunitetit Rom, ndërsa garon në kuadër të listës së një partie nga radhët e komunitetit Egjiptian. Parashtruesi i apelit ka bashkangjitur kopjen e vendimit 218/2021 të KQZ-së, një foto postimi të datës kandidatës, dhe kopjen e vendimit të PZAP-it Anr.14/2021.

PZAP-i më datën 29.01.2021 i ka dërguar Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) kërkesën për përgjigje në apel, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) në përgjigjen në apel thekson se Partia politike Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës (IRDK), si parti parlamentare që garon për ulëset e garantuara për komunitetin egjiptian të Kosovës, ka dorëzuar dokumentacionin për certifikim të kandidatëve të tyre me datën 16.01.2021, dhe Zyra ka bërë verifikimin e dokumentacionit sipas kërkesave ligjore. Më tutje në përgjigje theksohet se verifikimi i përkatësisë etnike të listës së kandidatëve të subjekteve politike që garojnë për ulëset e garantuara në Kuvendin e Republikës së Kosovës nuk është kërkesë e specifikuar as në LZP e as në Rregullat Zgjedhore të KQZ-së, pra përkatësia etnike bazohet në deklarinimin e subjektit politik në formularin e aplikimit i cili në këtë rast përputhet me të dhënat me rastin e regjistrimit si parti politike, dhe se Zyra nuk ka njohuri për ndonjë data bazë të shtetaseve të Kosovës e cila do të përmbante edhe përkatësinë etnike të qytetareve, dhe nuk ka njohuri për ekzistencën e ndonjë institucioni të Kosovës i cili do të mund të lëshoj certifikate të përkatësisë etnike.

PZAP-i, me datë 29.01.2021, i ka dërguar kërkesë për plotësim të apelit subjektit politik PLE, ku në përgjigje në plotësim të apelit me date 30.01.2021, subjekti politik PLE thekson se për vendimin nr.218/2021 të KQZ-së për certifikimin e kandidateve për deputet të IRDK-së, por duke mos qene pale direkte në procedure kemi qene të informuar me date 27 Janar 2021, me tutje thekson se pas publikimit të vendimit tjetër të PZAP-it Anr.14/2021, i cili për nga çështja qe e trajton është i ngjashëm me pretendimet ankimore të PLE, për sa i përket përkatësisë etnike të kandidatit për deputet dhe pas analizimit të këtij vendimi Anr.14/2021, ne si PLE me 28 Janar 2021 kemi parashtruar ankese në PZAP duke konsideruar se vlejné po të njëjtat vlerësime faktike dhe juridike si në rastin tonë. Po ashtu thekson se kandidatja për deputet nga subjekti politik IRDK, znj. Sabina Berisha e cila publikisht deklaroi se i takon komunitetit rom dhe do ti mbroje interesat e këtij komuniteti por qe pretendon të garoje në këto zgjedhje në një subjekt politik nga radhët e komunitetit egjiptian IRDK mbi këtë baze ne besojmë qe kandidimi i saj është i kundërligjshëm

Paneli pas vlerësimit paraprak të afatshmërisë së apelit, gjeti se:

Apeli është i pasafatshëm

Në këtë rast paneli nuk është lëshuar në themelësinë e apelit, pasi që i njëjti ishte ushtruar në PZAP, pas afati të përcaktuar ligjor, për arsye se vendimi i ankimuar i KQZ-së, në këtë rast është marrë publikisht dhe i njëjti vendim ishte publikuar në web-faqen e KQZ-së, me datë 22.01.2021, e që nga paneli vlerësohet si datë e dorëzimit të vendimit të çdo pale me interes ligjor siç është edhe në këtë rast parashtruesi i apelit. Duke marr për bazë faktin se vendimi i apeluar nuk e prek drejtpërdrejt një të drejtë apeluës, atëherë KQZ-ja nuk ka detyrim që një vendim të tillë t'ia dërgoj palës, por me publikimin e tij në webfaqe, nga ajo datë fillon të rrjedh afati për palët e interesuara, e që rrjedhimisht subjekti apeluës është palë e interesuar, dhe i njëjti ka dështuar që brenda afitit ligjor ta atakoj vendimin në fjalë.

Apeli i personave të interesuar si palë me interes ligjor është ushtruar në PZAP, me datë 28.01.2021, që rezulton të jetë pas afatit ligjor të përcaktuar me nenin 122 par. 1 të LZP-së, se: *“Personi fizik ose juridik, të drejtat ligjore të të cilit janë prekur nga cilat do vendime të KQZ-së, mund të apelojë atë vendim në PZAP brenda (24) orëve”*, siç del nga interpretimi i kësaj dispozite parashtruesi apelit ka pas afat ligjor që

brenda 24 orëve, të ushtroj apel në PZAP, nga momenti i publikimit të vendimit të ankimuar, e që në këtë rast apeli është paraqitur në PZAP, pas 6 dite kalendarike, ngase nuk mund të merret se pala ka rënë në dijeni se është dëmtuar me vendimin e ankimuar, vetëm në momentin kur PZAP, ka vendosur në një rast tjetër që sipas ushtruesit të apelit është i natyrës së njëjtë.

Duke u nisur nga arsyet e theksuara më lartë ne kuptim të nenit 115 paragrafi 1, dhe nenit 118 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Anr.18/2021 me datën 31.01.2021

Kryesues i Panelit
Faton Ademi



Këshillë Juridike: PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si perfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.